



REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/11/ 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/11/ 2023

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin TETOR 2023

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/11/2023 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 10 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin TETOR 2023 për 106 familje me një fond prej 264.440 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social B.Musaj

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



3/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/11/2023

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/11/2023

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin TETOR 2023

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____11/2023 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 11 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin TETOR 2023 për 272 familje me një fond prej **1.165.676** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social B.Musaj
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më: _____.2023.

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2023.

“Mbi miratimin e listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2024, në qytetin e Elbasanit”.

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 “Për strehim, social”, i ndryshuar, V.K.M. nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; V.K.M. nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/11/2023, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale (Sëktori i Strehimit);

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Listës emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje, për vitin 2024, në qytetin e Elbasanit”, sipas listës bashkëlidhur.
2. Miratimin në parim, të masës së subvencionimit të qirasë me vlerë totale prej **34.610.566.80 lekë** për periudhën (Janar-Dhjetor) viti 2024, për t’u financuar në masën 70% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën **24,227,396.76 lekë** dhe në masën 30% nga Bashkia Elbasan në vlerën **10,383,170.04 lekë**.
3. Paraqitjen e listës emërore të familjeve përfituese, bashkëlidhur këtij vendimi, për miratim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
4. Dhënia e subvencionimit do të bëhet për çdo rast pas verifikimit të plotësisimit të kritereve ligjorë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


SEKRETARI

Elvi Çuni

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: A. Beqiri
Dr.SH.S.: B. Musaj
Dr.B.F.: A. Merkja
Dr. P.P.S.S.SH.K.T.I.M: E. Yhaço
Dr. Juridike: A. Hoxha
Zv/Kryetare: A. Bylykbashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, ____ . ____ .2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë ____ . ____ .2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Lirije Nazif Jonuzi, banore në lagjen "Emin Matraxhiu", nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB nr. 58 datë 26.05.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasës **Znj. Lirije Nazif Jonuzi**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në shumën **395,150** (treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $405,301^1 \times 50\% = 202,650 + 192,500^2 = 395,150$ lekë.
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **395,150** (treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë, për familjen e **Znj. Lirije Nazif Jonuzi**, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr. 58 datë 26.05.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në orendi e pajisje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan më, _____.2023

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë: _____.2023

“Për emërtimin e shkollës së mesme të bashkuar në Njësinë Administrative Gjinar, me emrin “Kostandin Shpataraku”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës _____.2023, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë “Për emërtimin e shkollës së mesme të bashkuar Gjinar.” dhe mbështetur në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me ligjin 44/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 69/2012” ; VKM-në nr.662 datë 08.10.2014 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e IAPP”; Urdhri nr.31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore”; Udhëzimin nr.14 datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve mësimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” si dhe shkresës me nr.611/2 datë 12.10.2023 “Informacion për bashkimin e gjimnazit “Kostandin Shpataraku” me shkollën 9-vjecare “26 Shtatori” dhe shkresës me nr.611/3prot. datë 12.10.2023 “Kërkesë për miratimin e shkollës së mesme të bashkuar Gjinar” nga ZVAP Elbasan,

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e shkollës së mesme të bashkuar Gjinar, me emrin “Kostandin Shpataraku” në Njësinë Administrative Gjinar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit dhe Rinisë, pranë Bashkisë Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elvi Çuni

KRYETARI


Lutfi Lala

Konceptoi:

Drejtoria e DAR: J. Doci

Drejtoria Juridike: A. Hoxha

Zv/kryetare: V. Liço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ Datë: _____ .2023

Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në Njësinë Administrative Shirgjan dhe Tregan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 1, neni 64/a; ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar; ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për mjedisin" të ndryshuar ; ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullësor" të ndryshuar; të VKM nr. 550 datë 15.07.2020, si edhe pasi shqyrtoi kërkesat e subjekteve private sëbashku me relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kordinimit dhe Monitorimit:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Të miratojë në parim dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në të cilat shtrihet rrjeti inxhinierik i Ujrave Termale në funksion të subjekteve që ushtrojnë aktivitet për qendrat e tyre kurative termale me vendndodhje në Njësinë Administrative Shirgjan dhe Tregan.
2. Lista e subjekteve që do të lidhin marrëveshje me Bashkinë Elbasan do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Zona Kadastrale	Pasurite qe preken
1.	Kasem Çekrezi	1407	141; 145; 8; 177; 16
2.	Entela Preci	1407	1/17; 125;
		3633	8; 259/14;259/2
3.	Adrian Preci	1407	141; 145; 8; 1/17;
		3633	259/14; 259/2; 259/1

4.	Todi Puka	3833	140/1/1; 274; 141/1; 141/8; 145/7; 143; 145/9; 140/1/3
5.	Neki Boci	3633	140/1; 145/8; 145/9; 143
6.	Haziz Cekrezi	3633	140/1/3; 145/9; 140/1/2; 141/8;141/4;141/6; 274; 141/1
7.	Ndricim Kuqja	2727	202; 90/1; 203; 86; 170; 82/31; 209; 174/1;
		1407	174; 130; 141; 145; 8; 1/5
8.	Shkëlqim Hysa	3633	141/1; 274; 140/1/15

3. Subjektet përfitues të lejeve nga AMBU-ja do të lidhin kontratë e do të tarifohen në varësi të paketës fiskale të datës së lidhjes së marrëveshjes.”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, Drejtoria e Projektimit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike dhe Informacionit, Drejtoria e Kordinimit dhe Monitorimit.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvi Çuni

Lutfi Lala

Konceptoi:

Pranoi:

Miratoi :

Konfirmoi:

Sp. DKM

Përgj. Sekt.

Dr. DKM

Dr. DJ

DPPZH

B. Brahja

I. Kaçuli

T. Sinanaj

A. Hoxha

S.Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ Datë ___/___/2023

“Për

Një ndryshim të VKB me Nr.5 Dt 31/01/2023 mbi miratimin e normës për 1 mjet në administrim te administratorit Labinot Mal.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ___/___/___

VENDOSI:

1. Të miratojë normën shtesë për mjetin Nissan me targë **AB 175 FF** për efekt ndryshimi administratori ne Labinot Mal, sipas tabelës bashkëngjitur .
 2. Agjensia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidencimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjetit me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
 3. Ngarkohet Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Cuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Konceptoi: Specialist A. Balliu
Drejt. ASHP A. Lulaj
Zv/Kryetari A. Bylykbashi



9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë: _____.____.2023

**PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË SHITJES TË MATERIALIT DRUSOR, DRU ZJARRI
NË FUSHËN E BASHKISË ELBASAN**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54; Ligjin nr. 5/2016 "Për shpalljen e Moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr.438, datë 08/06/2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore" të ndryshuar; Udhëzimi Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje" Kreu I, dispozita të përgjithshme pika 14; Kontratat në fuqi me objekt "Shpenzime për prerje dhe transport dru zjarri" të lidhura midis operatorëve ekonomik dhe Bashkisë Elbasan.

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë tarifën e shitjes së materialit drusor, dru zjarri, në fushën e përcaktuar nga Bashkia Elbasan në vlerën 4495 (katërmijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë/mst.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: Qemal Poka

Pranoi: Jakov Bodurri

Miratoi: Shpëtim Çullhaj

Konfirmoi: Arben Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë _____ .2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.28, DATË 26.02.2020
“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK
PËR NDËRTIMIN E HEC_it “BUKANIKU” NË PËRROIN E QERSHISË”**

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”;
- Ligjit nr.57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1;
- VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar;
- VKM nr.888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”;
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.
- VKB nr.28, datë 28.02.2020 “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik për ndërtimin e HC-it “Bukaniku“ në përroin e Qershisë.

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI**

Të bëj shtesat dhe ndryshimet në VKB nr.28, datë 26.02.2020 “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik për ndërtimin e HC-it “Bukaniku” në përroin e Qershisë” si më poshtë vijon:

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore me gjatësi lineare prej **3.448 km** tubacion, **3.13 km** rrugë aksesi të përkohshme (sipas kohëzgjatjes së grafikut të punimeve), **0.12 ha** shesh depozitimi të përkohshëm dhe **10.879 km** linjë “Për ndërtimin e Hec_it Bukaniku në përroin e Qershisë” sipas listës bashkëlidhur.
2. Të dakortësohet në parim për heqjen nga fondi pyjor të **0.093 ha** sipërfaqe pyjore në n/ngastrat 5b,22b,23a,39b,40a,41a,42a dhe 42b ekonomia pyjore Shpat-2, n/ngastrat 3a,5a,8a,9a,101a,102a,103a,104a,105a ekonomia pyjore Polis-Vasjan dhe n/ngastrat nr.28c,70b,70c,72a,74a,75a,76a,78a,80/1 ekonomia pyjore Shpat-Shtërrmen për infrastrukturën përkatëse (Vepra e marrjes, dekantuesi, bazamentet e shtyllave dhe godina e Hec_it ‘Bukaniku’) që e ndryshojnë në mënyrë të përherëshme kategorinë e përdorimit të territorit në sipërfaqet që do të instalohen.
3. Vlera vjetore për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të jetë sipas studimit teknik-ekonomik dhe VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe

tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të bëj ndryshimet përkatëse në vlerë dhe gjatësinë lineare, në kontratë qiranë të lidhur me subjektin dhe raportin-teknik të hartuar për këtë veprimtari.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR
Lutfi LALA

Konceptoi: Astrit Muça

Pranoi: Jakov Bodurri

Miratoi: Shpëtim Çullhaj

Konfirmoi: Arben Hoxha



Nr.	ID Pronës	Ekonomia Pajore	Ngastra N/Ngastra	Përdorimi Territorit	Sipërfaqja që jepet në përdorim (ha)	Sipërfaqja që bieqet nga fondi pyjor (ha)	Rrugë	Linjë	Kanal/rub	Sip Shytlehi qet nga F.P (m2)	Nr. shyllës	Vlera lek/km/vit (Kanal/rub)	Lekë	Vlera lek/km/vit (Linja)	Lekë	Vlera lek/km/vit (Rruga)	Lekë	Vlera lek/ha/vit (shesh depositimi)	Lekë	Totali, Lekë
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
1	EL58 02 001a	EP Shpat-2	1a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.544	0	0	0	145000	49880	0	0	0	0	0	0	49880
2	EL58 02 002a	EP Shpat-2	2a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.27	0	0	0	145000	39150	0	0	0	0	0	0	39150
3	EL58 02 003a	EP Shpat-2	3a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.112	0	0	0	145000	16240	0	0	0	0	0	0	16240
4	EL58 02 003c	EP Shpat-2	3c	Improduktive	0	0	0	0.52	0	0	0	110000	57200	0	0	0	0	0	0	57200
5	EL58 02 004c	EP Shpat-2	4c	Improduktive	0	0	0	0.6	0	0	0	110000	66000	0	0	0	0	0	0	66000
6	EL58 02 005b	EP Shpat-2	5b	Pyll (cung.)	0	0.0073	0	0	0.209	0	0	145000	30305	0	0	0	0	0	0	30305
7	EL58 02 005c	EP Shpat-2	5c	Improduktive	0	0	0	0	0	0	0	110000	55000	0	0	0	0	0	0	55000
8	EL58 02 22b	EP Shpat-2	22b	Pyll (trung.)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	EL58 02 23a	EP Shpat-2	23a	Pyll (cung.)	0	0.00602	0	0	0.279	0	0	145000	40455	0	0	0	0	0	0	40455
10	EL58 02 23a	EP Shpat-2	23a	Pyll (cung.)	0	0.00602	0	0	0.279	0	0	145000	40455	0	0	0	0	0	0	40455
11	EL58 02 23b	EP Shpat-2	23b	Improduktive	0	0	0	0	0	0	0	110000	7700	0	0	0	0	0	0	7700
12	EL58 02 29	EP Shpat-2	29	Improduktive	0	0	0	0	0.07	0	0	175000	21525	0	0	0	0	0	0	21525
13	EL58 02 30b	EP Shpat-2	30b	Improduktive	0	0	0	0	0.123	0	0	175000	5500	0	0	0	0	0	0	5500
14	EL58 02 30a	EP Shpat-2	30a	Pyll (cung.)	0	0	0	0	0	0	0	145000	0	0	0	0	0	0	0	0
15	EL58 02 31b	EP Shpat-2	31b	Pyll (cung.)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16	EL58 02 31c	EP Shpat-2	31c	Pyll (cung.)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
17	EL58 02 31d	EP Shpat-2	31d	Improduktive	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
18	EL58 02 32b	EP Shpat-2	32b	Pyll (cung.)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
19	EL58 02 36c	EP Shpat-2	36c	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.484	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20	EL58 02 37a	EP Shpat-2	37a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.765	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
21	EL58 02 37b	EP Shpat-2	37b	Improduktive	0	0	0	0	0	0	0	110000	7700	0	0	0	0	0	0	7700
22	EL58 02 38b	EP Shpat-2	38b	Pyll (shkurre)	0	0	0	0	0	0	0	145000	4350	0	0	0	0	0	0	4350
23	EL58 02 41a	EP Shpat-2	41a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0	0.14	0	SH80	145000	13650	145000	20300	0	0	0	0	4350
24	EL58 02 41b	EP Shpat-2	41b	Improduktive	0.12	0	0	0	0	0	0	110000	9900	0	0	0	0	0	0	33930
25	EL58 02 42a	EP Shpat-2	42a	Pyll (shkurre)	0	0.0369	0	0	0.608	0.087	16 SH81-83;90	145000	12615	145000	88160	0	0	100000	12000	21900
26	EL58 02 42b	EP Shpat-2	42b	Improduktive	0	0	0	0	0	0	0	145000	56100	0	0	0	0	0	0	100775
27	EL48 00 003a	EP Polis-Vasjan	3a	Pyll (cung.)	0	0	0	0.51	0	24	SH84-89	0	0	110000	56100	0	0	0	0	56100
28	EL48 00 040a	EP Shpat-2	40a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.025	0	4	SH79	0	0	145000	3625	0	0	0	0	3625
29	EL58 00 039b	EP Shpat-2	39b	Pyll (trung.)	0	0	0	0.23	0	8	SH77-78	0	0	175000	40250	0	0	0	0	40250
30	EL48 00 005a	EP Polis-Vasjan	5a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.525	0	12	SH74-76	0	0	175000	94875	0	0	0	0	94875
31	EL48 00 007a	EP Polis-Vasjan	7a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.092	0	4	SH73	0	0	175000	16100	0	0	0	0	16100
32	EL48 00 008a	EP Polis-Vasjan	8a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.49	0	28	SH66-72	0	0	175000	85750	0	0	0	0	85750
33	EL48 00 009a	EP Polis-Vasjan	9a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.018	0	0	0	175000	3150	0	0	0	0	0	0	3150
34	EL48 00 101a	EP Polis-Vasjan	101a	Improduktive	0	0	0	0.267	0	8	SH64-65	0	0	175000	46725	0	0	0	0	46725
35	EL48 00 102a	EP Polis-Vasjan	102a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.624	0	20	SH59-63	0	0	110000	68640	0	0	0	0	68640
36	EL48 00 103a	EP Polis-Vasjan	103a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.374	0	4	SH58	0	0	175000	47950	0	0	0	0	47950
37	EL48 00 104a	EP Polis-Vasjan	104a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.558	0	8	SH53-54	0	0	175000	58975	0	0	0	0	58975
38	EL48 00 105a	EP Polis-Vasjan	105a	Pyll (trung.)	0	0	0	0.595	0	16	SH49-52	0	0	175000	94150	0	0	0	0	94150
39	EL59 00 080/1	EP Shpat-Shitërmen	80/1	Kullotë	0	0	0	0	0	24	SH43-48	0	0	145000	35670	0	0	0	0	35670
40	EL59 00 070a	EP Shpat-Shitërmen	70a	Pyll (cung.)	0	0	0	0.448	0	0	0	145000	64960	0	0	0	0	0	0	64960
41	EL59 00 070b	EP Shpat-Shitërmen	70b	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.738	0	20	SH38-42	0	0	145000	107010	0	0	0	0	107010
42	EL59 00 070c	EP Shpat-Shitërmen	70c	Sip.bimësi	0	0	0	0	0	12	SH35-37	0	0	110000	55880	0	0	0	0	55880
43	EL59 00 072a	EP Shpat-Shitërmen	72a	Kullotë	0	0	0	0	0	28	SH28-34	0	0	145000	118900	0	0	0	0	118900
44	EL59 00 078a	EP Shpat-Shitërmen	78a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0.971	0	24	SH20-25	0	0	145000	140795	0	0	0	0	140795
45	EL59 00 075a	EP Shpat-Shitërmen	75a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0	0	8	SH26-27	0	0	145000	47850	0	0	0	0	47850
46	EL59 00 076a	EP Shpat-Shitërmen	76a	Pyll (shkurre)	0	0	0	1.024	0	32	SH12-19	0	0	145000	148480	0	0	0	0	148480
47	EL59 00 074a	EP Shpat-Shitërmen	74a	Pyll (shkurre)	0	0	0	0	0	12	SH9-11	0	0	145000	45330	0	0	0	0	45330
48	EL59 00 028c	EP Shpat-Shitërmen	28c	Pyll (shkurre)	0	0	0	0	0	16	SH3-6	0	0	145000	30015	0	0	0	0	30015
SHUMA:					0.12	0.05902	3.130	10.879	3.448	344		457150	1620965	142935	12000					2,213,050

Shënim: Të dhënat mbi kategorinë e përdorimit dhe sipërfaqen e përdorimit të territorit dhe mbrojtjes pyjore janë bazuar sipas planëve të mbrojtjes pyjore dhe PKM nr.559, dt.29.07.2022.Për përcaktimin e emimeve dhe tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave 'i ndryshuar'.

Vlera dyfishme mbi ligëzuarjen e dhënë në përdorim të fondit pyjor/kullorës janë të bazuara në PKM nr.559, dt.29.07.2022.Për përcaktimin e emimeve dhe tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave 'i ndryshuar'.

Specialisti i Kadasit

Astrit Muca

Përgjegjësi i Sektorit

Jakov Bërdorri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
PROJEKT - VENDIM
Nr. _____ datë _____ 2023

“PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM”
PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTE PËR PANELE FOTOVOLTAIKE
ME QËLLIM PRODHIMIN E ENERGJISË”

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”.
- Te ligjit nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1
- VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 45 (dyzet e pesë) ha për “vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë” ne ngastrat nr 59/a,65/b,66/b dhe 75/e ne ekonomine pyjore ‘Labinot’ me nje afat 10 (dhjetë) vjet nga lidhja e kontrates.
2. Vlera vjetore dysHEME e dhënies ne perdorim të jete sipas studimit teknik-ekonomik dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Konceptoi: Q.Poka

Pranoi: J.Bodurri

Miratoi: Sh.Çullhaj

Dr.Juridike: A.Hoxha

KRYETAR

Lutfi Lala

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____/____/2023



REPUBLICA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
PROJEKT - VENDIM
Nr. _____ datë _____ 2023

**“PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM”
PËR VENDOSJE STACIONESH, BAZAMENTE PËR PANELE FOTOVOLTAIKE
ME QËLLIM PRODHIMIN E ENERGJISË”**

- Në mbështetje Të ligjit nr.139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”.
- Te ligjit nr.57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenin 25 pika 1
- VKM nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik.
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI**

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 33 (tridhjetë e tre) ha per “vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë” ne ngastrat nr 14/a,15/a,16/a ne ekonomine pyjore ‘Labinot’ me nje afat 10 (dhjetë) vjet nga lidhja e kontrates.
2. Vlera vjetore dysHEME e dhënies ne perdorim të jete sipas studimit teknik-ekonomik dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559 dt.29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
3. Ngarkohen për zbatimin e ketij vendimi Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Konceptoi: Q.Poka

Pranoi: J.Bodurri

Miratoi: Sh.Çullhaj

Dr.Juridike: A.Hoxha

KRYETAR

Lutfi Lala


Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN

Nr. ____ Prot

Elbasan, më _____.2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ datë _____.2023

**“PËR
MIRATIMIN E SHITJES SË NJË PJESE TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
TREGTARE SPORTIVE “AKADEMIA E FUTBOLLIT ELBASAN” SH.A**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2023, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a., relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë mbi shitjen e një pjesë të aksioneve të shoqërisë “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a. dhe raportin e vlerësimit të ekspertit kontabël, me qëllim rritjen dhe performancën financiare dhe sportive të shoqërisë, si aksioner i vetëm i shoqërisë dhe pronar 100% i aksioneve të saj, bazuar në ligjin Nr. 79/2017 “Për sportin”, ndryshuar me ligjin Nr.105/2020, neni 11, pika “ç”, neni 20, pika 2 dhe neni 22, ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2(a),(c), neni 36, pika 2 dhe neni 54, pika (e), ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 116, neni 117 (pika 1/“b”) e vijues, Kodit Civil të RSH, neni 705 e vijues,

VENDOSI

1. Të miratoj raportin e vlerësimit të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a, me NIPT- M13113202A, të hartuar nga shoqëria AL-TAX.
2. Të miratojë shitjen e 70% të aksioneve të shoqërisë tregtare sportive “Akademia e Futbollit Elbasan” sh.a, me NIPT- M13113202A, ku bashkia Elbasan aktualisht është aksionar i vetëm, duke patur pronësinë e 100 aksioneve të shoqërisë, e vlerësuar në shumën 19.769.500 lekë sipas aktit të vlerësimit të ekspertit kontabël.
3. Të nxirren në shitje, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, gjithsej 70 (shtatëdhjetë) aksione, me vlerë fillestare të ankandit 13.838.650 lekë,
4. Autorizohet Kryetari dhe administrata e Bashkisë për të zhvilluar të gjitha procedurat e shitjes dhe lidhjen e kontratës së shitjes së aksioneve të shoqërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sek. K. Bashkiak
Elvi Çuni**

**Kryetari
Lutfi Lala**

*Sek. P.S.M.A.
Për Klubin Shumesportësh Drejt.
Dr. Buxhetit dhe Financës
D.P.A.B.F.
Drejt. Juridike*

*E. Jorgji
A. Kovaçi
A. Mehja
Q. Tusha
A. Hoxha*